



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:081541

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05746615

P.nr. 81/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Dega Viti, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, në çështjen penale ndaj të pandehurit S.M. nga fshati B., Komuna Viti, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, PP.II.nr.352/2024, e datës 11.03.2024, jashtë seancës, me datë 28.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit S.M., nga fshati B., Komuna Viti, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi të KPRK-së dhe **HEDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, PP.II.nr.352/2024, e datës 11.03.2024, për shkak se i pandehuri është i vdekur.

E dëmtuara KEDS, Distrikti në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i përgjithshëm, me datën 13.03.2024, në Gjykatën Themelore në Gjilan, Dega në Viti ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.352/2024, e datës 11.03.2024, dhe kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor, PP.II.nr.352/2024, e datës 11.03.2024, ndaj të pandehurit S.M., nga fshati B., Komuna Viti, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-së.

Gjykata me parashtrësën P.nr. 81/2024, të datës 22.05.2024, ka kërkuar nga Komuna e Vitisë - Zyra e Regjistrimit Civil, kërkesë për konstatimin e vdekjes së të pandehurit S.M., i lindur më 30.10.1956, me numër personal Të njëjtit i janë përgjigjur gjykatës duke e dorëzuar Certifikatën e vdekjes të të pandehurit, me numër V, me numër të referencës, me numër rendor, e datës, me të cilën vërtetohet se i pandehuri S.M, nga fshati B., Komuna Viti, i lindur me datë, me numër personal është person i ndjerë dhe ka vdekur me datë, në Gjilan, ndërsa vdekja është regjistruar me datë

Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPPRK-së, të dëmtuarën KEDS, Distrikti në Gjilan për realizimin e kërkesës pasurore juridike e ka udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Andaj, gjykata në pajtim me nenin 158 paragrafi 1 të KPPRK-së, si dhe duke marrë parasysh se i pandehuri S.M., nga fshati B., Komuna Viti është i vdekur, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-dega Viti
Departamenti i përgjithshëm
P.nr.81/2024, me datë: 28.05.2024

Gjyqtarja,
Blerina Jakupi Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.